

L I G J
Nr.9006, datë 13.2.2003

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR PËR PROJEKTIN “FURNIZIMI ME UJË DHE SHKARKIMI I UJËRAVE TË ZEZA NË KORÇË II””

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar për projektin “Furnizimi me ujë dhe shkarkimi i ujërave të zeza në Korçë II””, me një hua prej 6 646 794, 46 Euro.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3720, datë 28.2.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu.

MARRËVESHJE

NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR
(VITI 2001)

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë:

Në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë;

duke u nisur nga dëshira për t’i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet bashkëpunimit financiar si partnerë;

të ndërgjegjshme se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj marrëveshjeje;

me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë;

duke iu referuar protokollit të bisedimeve ndërqeveritare shqiptaro-gjermane të datës 5 dhjetor 2001,

ranë dakord si vijon:

Neni 1

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i jep mundësi Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe marrësve të tjerë, që do të zgjidhen bashkërisht nga të dy Qeveritë, të marrin nga Kreditansalt für Wiederaufbau, Frankfurt mbi Majn, një hua prej gjithsej deri në 6.646.794,46 euro (gjashtë milionë e gjashtëqind e dyzet e gjashtë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e katër 46/100 euro) për projektin “Furnizimi me ujë dhe shkarkimi i ujërave të zeza në Korçë II”, kur nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se projekti vlen për t’u mbështetur.

2. Po të merren vesh Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të

Gjermanisë, projekti i përmendur në paragrafin 1 mund të zëvendësohet me projekte të tjera. Në qoftë se projekti i përmendur në paragrafin 1 do të zëvendësohet me një projekt, i cili plotëson kushtet e posaçme për mbështetjen nëpërmjet një shume financimi, si projekt në fushën e mbrojtjes së mjedisit ose të infrastrukturës sociale ose si fond garantues të kredive për ndërmarrjet e mesme, ose si masë, e cila i shërben përmirësimit të pozitës shoqërore të grave, ose si masë për zhdukjen e varfërisë – sipas parimit të aftësisë për të ndihmuar vetveten - atëherë mund të jepet një shumë financimi, ndërsa përndryshe mund të jepet një hua.

3. Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, në një kohë të mëvonshme, do t'i japë mundësi Qeverisë së Republikës së Shqipërisë të marrë nga Kreditansalt für Wiederaufbau hua të tjera ose shuma të tjera financimi, për përgatitjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, ose shuma financimi për masa të nevojshme shoqërore, për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, atëherë do të gjejë zbatim kjo Marrëveshje.

Neni 2

1. Përdorimi i shumës së përmendur në nenin 1 paragrafi 1, kushtet me të cilat vihet në dispozicion ajo, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratën, e cila do të përfundohet midis Kreditansalt für Wiederaufbau dhe huamarrësve dhe do t'u nënshtrohet dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë. Premtimi i shumës së përmendur në nenin 1 paragrafi 1 do të zhvlefësohet, në rast se kontrata përkatëse për huanë nuk përfundohet brenda një afati prej tetë vjetësh pas vitit të premtimeve. Për shumën në fjalë, ky afat mbaron, më datë 31 dhjetor 2009.

2. Qeveria e Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ajo vetë nuk është huamarrëse, do të garantojë ndaj Kreditansalt für Wiederaufbau të gjitha pagesat me euro për plotësimin e detyrimeve të huamarrësve në bazë të kontratës që do të përfundohet sipas paragrafit 1.

Neni 3

Qeveria e Republikës së Shqipërisë e liron Kreditansalt für Wiederaufbau nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike, të cilat merren në Shqipëri, lidhur me përfundimin dhe zbatimin e kontratës së përmendur në nenin 2.

Nenin 4

Qeveria e Republikës së Shqipërisë i lejon pasagjerët dhe furnizuesit të zgjedhin lirisht ndërmarrjet transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë tokësore dhe ajrore që rezultojnë nga dhënia e huasë; nuk merr asnjë masë, e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve me qendër në Republikën Federale të Gjermanisë dhe nxjerr në rastet e duhura lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Neni 5

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën, kur Qeveria e Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen e saj në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë, më datë 11 dhjetor në dy origjinale, secili në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur secili tekst fuqi të barabartë.